- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*)

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[**Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit**]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula****Shtojca 5.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizojnë produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.Sistemi i Endoskopise

1.1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE VIDEO PROCESORIT HD DHE BURIMIT TE DRITES

- a) Pajisja e videoprocessorit duhet të jetë Full HD dhe të jetë në një njësi të vetme me burimin e dritës së ftohtë LED. Pajisja duhet të ketë funksionin e zmadhimit të figurës.
- b) Pajisja duhet të ofrojë disa modalitete për permirsimin e imazhit IEE, me ane të teknologjise (imazhe me ndricim blu, imazhe me ngjyra të lidhura dhe spekter fleksibel për permirsimin e ngjyrave) për të ndihmuar doktorin në detektimin e polipeve, adenomave etj dhe në karakterizimin e sakte të tyre.
- c) Sistemi të ketë tastieren specifike të tij dhe të ofrojë të paktën 3 butona për komanda të kontrolluara nga videoendoskopet, si psh freezing etj.
- d) Të ketë të integruar modalitetin automatik për ruajtjen e të dhënave dhe procesori të jete gjithashtu i kompatibel me DICOM.
- e) Në pjesën e pasme të pajisjes së videoprocessorit duhet të ketë dalje të broadcastit të dritës dhe 2 dalje DVI-D.
- f) Pajisja duhet të funksionojë në rryme elektrike me frekuencë 50/60 Hz, dhe voltazh 220-230 Volt.
- g) Burimi i ftohtë i dritës duhet të sigurojë ndriçimin minimalisht me 3 LED.
- h) Burimi i dritës duhet të ketë funksionin e rregullimit automatik të intensitetit të dritës (të rritjes dhe zvogëlimit) nëse largohet shumë nga indet ose nëse afrohet.
- i) Rregullimi manual i dritës duhet të jetë i mundur me burimin e ftohtë.
- j) Pajisja duhet të jetë e azhornueshme(upgradable) me pajisjen e inteligjencës artificiale e cila mund të detektojë anomalitë dhe të karakterizojë indin përkatës si neoplastik ose hiperplastik në real-time dhe në të njëjtin ekran ku doktori realizon procedurën endoskopike

1.2 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PAJISJES VIDEOGASTROSKOPI HD

- a) Pajisja video gastroskop duhet të jetë e përshtatshme për përdorim diagnostikues dhe terapeutik dhe duhet të jetë HD (High Definition).

-
- b) Video gastroskopi duhet të ofroje teknologji te vecanta qe te perputhet me modalitetet e permirsimit te imazhit IEE (imazheve me ndricim blu, imazheve me ngjyra te lidhura dhe spekterit fleksibel te permirsimit e ngjyrave)
 - c) Këndi i fushes se shikimit të video gastroskopit duhet të jetë te pakten 140 gradë.
 - d) Thellësia e fushes se shikimit të video gastroskopit duhet të jetë midis 2-100 mm.
 - e) Drejtimi i fushes se shikimit te video gastroskopit duhet të jetë me shikim në pjesen frontale.
 - f) Diametri i jashtëm i tubit të futjes së video gastroskopit duhet të jetë maksimumi 9.9 mm.
 - g) Video gastroskopi duhet të ketë një diametër të jashtëm distal prej maksimumi 9.8 mm.
 - h) Kanali i punës i video gastroskopit duhet të ketë një diametër të brendshëm prej te pakten 2.8 mm.
 - i) Gjatësia e dobishme e punës së video gastroskopit duhet të jetë sa paku 1100 mm, dhe gjatësia totale duhet të jetë së paku 1.400 mm.
 - j) Kapaciteti i lakimit të majës së videos gastroskopit duhet të jete lart deri ne 210 gradë, poshtë 90 gradë, djathtas 100 gradë, majtas 100 gradë.
 - k) E gjithë pajisja duhet të jetë në një strukturë të papërshkueshme nga uji dhe të jetë në gjendje të zhytet plotesisht në lëngun e dezinfektimit.
 - l) Skopi pervec kanalit uje/ajer te kete nje kanal te vecante per nxjerrjen e ujit me presion per pastrim te lenteve nga papastertite dhe hemoragjite.
 - m) Butonat e ajrit / ujit dhe aspirimit të video gastroskopit duhet të jenë të këmbyeshem kur të konsumohen.

1.3 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PAJISJES VIDEOKOLONOSKOPI HD

- a. Pajisja e video kolonoskopit duhet të jetë e përshtatshme për përdorim diagnostikues dhe terapeutik dhe duhet të jetë HD (High Definition).
- b. Video kolonoskopi duhet të ofroje teknologji te vecanta qe te perputhet me modalitetet e permirsimit te imazhit IEE (imazheve me ndricim blu, imazheve me ngjyra te lidhura dhe spekterit fleksibel te permirsimit e ngjyrave)
- c. Këndi i fushes se shikimit të videokolonoskopit duhet të jetë te pakten 170 gradë.
- d. Thellësia e fushes se shikimit te videokolonoskopit duhet të jetë midis 2-100 mm.
- e. Drejtimi i fushes se shikimit të video kolonoskopit duhet të jetë frontal.
- f. Diametri i jashtëm i tubit të futjes së video kolonoskopit duhet të jetë maksimumi 12 mm.
- g. Diametri i jashtëm distal i video kolonoskopit duhet të jetë maksimumi 12 mm.
- h. Kanali i punës i video kolonoskopit duhet të ketë një diametër të brendshëm prej te pakten 3.2 mm.
- i. Gjatësia e dobishme e punës së video kolonoskopit duhet të jetë te pakten 1680 mm.
- j. Kapaciteti i lakimit të majës së video kolonoskopit duhet të jetë 180 gradë lart, 180 gradë poshte, djathtas 160 gradë, majtas 160 gradë.
- k. E gjithë pajisja duhet të jetë me një strukturë të papërshkueshme nga uji dhe të jetë plotësisht e zhytshme në lëngun e dezinfektimit.
- l. Skopi pervec kanalit uje/ajer te kete nje kanal te vecante per nxjerrjen e ujit me presion per pastrim te lenteve nga papastertite dhe hemoragjite.
- m. Butonat e ajrit / ujit dhe aspirimit të video duhet të jenë të këmbyeshem kur konsumohen.
- n. Te jete kompatibel me modulet e inteligjences artificiale
- o. Kolonoskopi duhet te jete i pajisur me mekanizem kontrolli te fleksibilitetit, e cila i lejon doktorit ta beje trupin e endoskopit me shume ose me pak fleksibel, sipas situates, per te thjeshtuar penetrimin.

Specifikimet e aksesoreve tjere te sistemit endoskopik qe duhet te jene te perfshire:

1. Monitori i sistemit,

a) duhet të jetë i teknologjise LED. te pakten 27 inç dhe me rezolucion të imazhit të paktën 1920x1080 piksel. Monitori duhet të ketë hyrje DVI.

2. Sistemi kompjuterik per transferimin dhe arkivimin e imazheve dhe videove digjitale

- a) Duhet të ketë një pedal të dyfishtë për regjistrim dixhital të fotove dhe videove.
- b) Duhet të jetë në gjendje të bëjë foto ndërkohe qe bën video.
- c) Duhet të ketë aftësinë të shikojë videot e regjistruara frame-by-frame dhe të regjistrojë imazhet nga secila frame.
- d) Me sistemin duhet të sigurohet 1 printer me ngjyra me boje inkjet.
- e) Duhet të sigurohet një kompjuter desktop ose laptop me të paktën 2 Ghz procesor dual core, të paktën 2 GB RAM, të paktën 500 GB Harddisk, të paktën 14 "ekran LCD ose LED, duke përfshirë Mouse, Tastierë, DVD writer.
- f) Duhet të sigurohet kablo transmetimi video e gjatë së paku 10 metra.

3. Karrel

- a) Në karrelin e propozuar të transportit te sistemit, të gjitha kabllot e lidhjeve elektrike duhet të jenë në gjendje të fiksohen në një seksion.
- b) Sistemi duhet të jetë i aftë të lidhet në rrjetin e ushqimit me një kablo të vetme lidhëse.
- c) Ai duhet të jetë në gjendje të mbajë mbi vete procesorin me burimin e Dritës, si dhe Monitorin e kerkuar
- d) Duhet të jetë në gjendje të mbajë të paktën dy endoskope në të dhe për këtë, duhet të ketë një varëse mbajtëse në karrelin transportues.
- e) Të paktën dy rrota duhet të kenë mekanizëm bllokimi.

4. Pompe thithese Elektrike

a) me dy gota me kapacitet 3 liter, me force thithese 60 litra per minut, e pajisur dhe me pedal komandimi me kembe

5. Pajise per testimin e rrjedhjes 1 cope

6. Aksesoret per pastrimin e Skopeve 1 set

7. Bllokues kafshimi 400 cope

8. Njesi Elektrokirurgjikale

Elektrobisturi per perdorim ne procedura mono dhe bipolare njekohesisht.Per perdorim te gjere ne aplikacione si:kirurgji, endoskopi, gastroenterologji etj
Tensioni i hyrjes:220-230 Volt 50/60Hz
Fuqia elektrike e hyrjes 1000VA

Fuqia Maksimale e daljes:300W
E paisur me sistemin TACS(Tissue Adaptive Contact System)
Funksionet qe duhet te kryeje: Cut/Coag.
E paisur me cark pacienti(pllake tokezimi adult)
E paisur me fishe qe lidhe gjeneratorin me aksesoret Snare
E paisur me monitorim te fuqise se daljes
E paisur me vete-testim te korrenteve te rrjedhjes
Kompensim i luhatjes ne rrjet

9. Aksesori te autoklavueshme:

- a) *Biopsi forceps disposable Alligator coated me diameter 2.4mm. pese me gjatesi 1500 mm dhe pese me gjatesi 2100 mm.*
- b) *Biopsy forceps oval fenestrated cups me diameter 2.4. nje me gjatesi 1500 mm dhe nje me gjatesi 2100 mm.*
- c) *Ovale Snares me diameter laku 30 mm dhe diameter trupi 2.4 mm. nje me gjatesi 1600 mm dhe nje me gjatesi 2300 mm*
- d) *Hexagonal Snares me diameter laku 30 mm dhe diameter trupi 2.4 mm. nje me gjatesi 1600 mm dhe nje me gjatesi 2300 mm*
- e) *Oval, rotatable me diameter laku 30 mm dhe diameter trupi 2.4 mm. nje me gjatesi 1600 mm dhe nje me gjatesi 2300 mm*
- f) *Sclerotherapy Needle, nje me gjatesi totale 1650 mm dhe me maje gjilpere 6mm dhe diameter trupi 2.4mm. Dhe nje me nje me gjatesi totale 2300 mm dhe me*

maje gjilpere 6mm dhe diameter trupi 2.4mm

2. Lare dhe Dizinfektues Automatik Endoskopie

- a) I pershtatshem per perdorim me dezinfektues te lengshem per te gjitha llojet e endoskopeve. I pershtatshem per dezinfektues me 1 perdorim (te perqendruar) si dhe me dezinfektues periodik te gatshem.
- b) Paisja te ofroje dy kontenier te vecante per ruajtjen e dizinfektanteve te ndryshem per perdorim te ndryshem (gastroskope, kolonoskope, bronkoskope etj) te cilet nuk perzihen me njeri-tjetrin dhe nuk kontaminojne njeri tjetrin.
- c) Paisja te ofroje mundesine e dezinfektimit te dy endoskopëve në të njëjtën kohë per te kursyer kohe dhe solucione.
- d) Paisja te ofroje nje gjerësi te mjaftueshme per akomodimin e dy endoskopeve gjate larjes, ` pa i perkulur shume ato.
- e) Paisja te kryeje dezinfektimin e endoskopëve të të gjitha markave.
- f) Te zotëroje disa programe automatike të larjes. Te lejoje perdoruesit të rregullojnë programet dhe të ndryshojnë titujt e tyre. Te lejoje që programet automatike të ekzekutohen edhe manualisht.
- g) Sistemi te ofroje gjuhen angleze per menune e perdorimit dhe mesazhet e paralajmërimit-gabimit.
- h) Pas cdo larje, sistemi vet-pastron lavamanin dhe rezervuarët dhe i bën ato gati për larje tjetër.
- i) Nëse pajisja nuk përdoret për 24 orë ose më shumë, lavamani pastrohet automatikisht para dezinfektimit te radhes dhe është gati për perdorim.
- j) Paisja te kete ekran LCD dhe tastiere me prekje per kontroll dhe te ofroje aksesimin e shpejte te programeve me te perdorura me shortcuts.

-
- k) Paisja siguron dozim të saktë të solucionëve me sistemin e dozimit të lidhur me dezinfektuesin e përqendruar, pastruesin enzimatik dhe rezervuarin e alkoolit.
 - l) Paisja të tregojë numrin e operacionëve të dezinfektimit të papërfunduara ose të përfunduara, kohën totale të punës dhe kohën e ndryshimit të filtrit, si dhe paralajmëron përdoruesin në mënyrë të dëgjueshme dhe vizuale për ndryshime.
 - m) Paisja të ofrojë mbrojtje me password, që ndalon përdoruesit e paautorizuar të kenë qasje në programet e pajisjes.
 - n) Sistemi të ofrojë kyçje automatike të mbulesës së pajisjes gjatë operimit që nuk lejon hapjen gjatë periudhës së larjes (EN 15883).
 - o) Sistemi të ofrojë filtrim të ujit për të përmirësuar cilësinë e dezinfektimit duke filtruar ujin e rubinetit.
 - p) Sistemi të ofrojë mbrojtje elektrike për të mbrojtur çdo përdorues nga rreziku i rrjedhjes së rrymes.
 - q) Sistemi të sigurojë që uji i përdorur të dërgohet automatikisht në sistemin e derdhjes së ujerave.
 - r) Sistemi të jetë i pajisur me rrota për të zhvendosur lehtësisht nga një vend në tjetrin, dhe në të njëjtën kohë rrotat të jenë të pajisura me frenë për të fiksuar në vend.
 - s) Ajri i furnizuar në kanalet e endoskopit të sterilizohet nga sistemi i filtrit Hepa (EN 15883).
 - t) Mbulesa e lavamanit të parandalojë ndotjen nga brenda-jashtë ose nga jashtë-brenda.
 - u) Sistemi të ofrojë tregues të nivelit të solucionëve në pjesën e përparme të pajisjes. Nivelet e rezervuareve dezinfektuese të jenë lehtësisht të dukshme nga përdoruesi. Në të njëjtën kohë, kapakët mbushës të janë të etiketuar me ngjyra të ndryshme.
 - v) Paisja të mundësojë shkarkim manual të rezervuarëve të solucionëve dhe të sigurojë mbetje minimale në rezervuar pas shkarkimit.
 - w) Sistemi i tharjes të jetë me opsione të rregullueshme Alkool-Ajër ose vetëm Ajër, duke siguruar tharje më të mirë të brendësisë së endoskopëve.
 - x) Për të zgjidhur problemet e mundshme, sistemi të ofrojë një sistem testimi dhe simulimi që mund të kontrollojë të gjitha hyrjet dhe daljet e pajisjes.
 - y) Paisja të ofrojë të paktën 12 programe të larjes.
 - z) Sistemi të punojë me AC 220 / 230V 50/60 Hz
 - aa) Paisja të vijë me kampionet e dezinfektuesëve për berjen e testimit të pajisjes në momentin e instalimit dhe tranjimin e personelit për përdorimin e pajisjes

3. Kabineti i ruajtjes dhe i tharjes së skopeve

- a) I përbërë nga material celik Inox (Çilesi AISI 304) me katër rrota (me frenë) për transport të lehtë.
- b) Kapaciteti i ruajtjes dhe i tharjes minimalisht deri në 7 skope.
- c) Kontrolli me anë të një monitori LCD dhe monitorim të nxehtësisë, lagështirës dhe parametrave të kohës
- d) Mundësi të caktimit të temperaturës të brendshme minimalisht nga 25°- 45° Celsius
- e) Të ketë minimalisht 2 siguresa nxehtësie të pavarura në mënyrë që të parandalojë rritjen e nxehtësisë
- f) Të ketë filtra të zëvendësueshëm dhe prej materiali që lahen në ventilatorin tharës që ndalojnë pluhurat
- g) Të ketë sistem ventilimi pa zhurmë dhe pa dridhje
- h) Sistem LED dhe UV të sinkronizuar me Deren
- i) Sistemi UV të mos punojë kur dera është e hapur (sistemi UV të operojë me valen më efektive 254 NM).

-
- j) Dera te jete me xham te temperuar me trashesi minimale prej 6mm per ndalimin e kalimit te rrezeve ultravjollce
 - k) Te jete i perbere minimalisht nga 4 shkarkues ajri te filtruar dhe antibakterial qe thajne kanalet e brendshme te skopeve.
 - l) Vareset e skopeve te rrotullohen 360° pa zhurme. Te levishme dhe te pastrueshme lehte.
 - m) Te kete grrile per nxjerrjen e lageshtires te ajrit
 - n) Te kete sistem drenazhi per nxjerrjen e ujit te akumuluar poshte kabinetit
 - o) Rryma e punes- 220 V, maksimumi 1.5 KW
 - p) Permasat: jo me shume se 100 cm e gjere dhe jo me pak se 220 cm e larte (gjeresia per shkak te hapshires ne ambientin ku do instalohet ndersa lartesia per shkak te skopeve qe jane deri ne 210 cm te gjate).

4. Shtrati

- a) Baza dhe kolona te jene prej celik inoxi. Te jene te pastrueshme lehte dhe te dezinfektueshme.
- b) Tavolina operatore duhet te jete e paisur me rrota per te levizur dhe me frena per ta fiksuar ne vend.
- c) Duhet te kete pedal me pompe vaji per te rregulluar lartesine
- d) Gjatesia e shtratit duhet te jete jo me pak 2100mm dhe gjeresia e shtratit jo me pak se 500mm
- e) Pjesa e kembeve te shtratit duhet te jete e levizshme ne anen laterale
- f) Duhet te jete i paisur me aksesoret per mbajtjen e kraheve ne pozicionin lateral
- g) Duhet te kete si aksesore rripat e shterngimit
- h) Lartesia e rregullueshme minimalisht nga 760-1100 cm
- i) Peshat maksimale e pacientit qe duhet te suportojte shtrati nuk duhet te jete me e vogel se 200 kg
- j) Kendi I levizjes te pllakes te shpines jo me pak se lart 75°, poshte 15°
- k) Kendi I levizjes te pllakave te kembeve jo me pas se lart 15°,poshte 85° dhe anesore 90°
- l) Kendi I levizjes trendelenburg dhe anasjelltas jo me pak se 22°/22°
- m) Rregullimi I ures jo me pak se 120 mm
- n) Kendi I animit (majtas, djathtas) jo me pak se 20°/20°,

Secila pajisje duhet te kete manualet e perdorimit te pajisjes dhe manualet teknike

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit: 2 muaj nga nënshkrimi i kontrates

Artiku Ili.	Përshkrimi	Njesia	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorezimit
1	Sistem Video gastrokolonoskopi (perfshire gastroskop,kolonoskop,burim drite+videoprosesor,monitor,karrel,systemkomp).Per magazinim te imazheve,pompe thithese,elektrobist,aksesore te autoklavueshem,bllokues kafshimi,set pastrami te skopeve)	cope	1	SRSH	2 muaj nga nënshkrimi I kontrates
2	Lares Dezinfektues Endoskopie	cope	1	SRSH	2 muaj nga nënshkrimi I kontrates
3	Kabinet Ruajtje dhe Tharje	cope	1	SRSH	2 muaj nga nënshkrimi I kontrates
4	Shtrat pacienti	cope	1	SRSH	2 muaj nga nënshkrimi I kontrates
	Totali pa TVSH				9 775 000

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë **perfshire muajin Maj 2021**.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;*

c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

ç. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës (195 500 njeqind e nentëdhjete e pesemije e peseqind).*

- ✓ Në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme/kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të çertifikuara/vërtetuara të **bilanceve për vitet 2018, 2019,2020** të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet.

b.) Dokument nga Administrata Tatimore ku të vërtetohet xhiroja vjetore për tre vitet 2018 ,2019, 2020, të jete në vlerën prej 40% të fondit limit që prokurohet

2.3 Kapaciteti teknik:

Deshmi për furnizime të meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në vlerën prej 20% e fondit limit që prokurohet (nga data e zhvillimit të tenderit).

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) Inxhinier: Biomedikal ose elektronik të trajnuar për instalim dhe servis pajisjesh mjekësore.

Per kete duhet te paraqese:

- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore(formulet E-sig 025) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit per inxhinierat bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.
- Kontrate pune te vlefshme gjate periudhes se ekzekutimit te kontrates.
- Diplomat perkatese
- CV-ja
- Certifikata/ose deshmi trajnimi te tyre per pajisjet mjekesore(**Sistem Video gastrokolonoskopi**).

3.Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje pajisjet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

4. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import/eksport/tregetim të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën perkatese, të vlefshme. *Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent,ose ISO 13485 ”Per Sistemin e menaxhimit te cilesise per pajisjet mjekesore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për **prodhuesin/t** e artikujve të ofruar ose **Vedeklarim nga Operatori Ekonomik që eshte konform standartëve të cilësisë**

Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

6.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, ose FDA të vlefshme për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre ne VENDIM Nr. 731, datë 2.9.2015 PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE, VLERËSIMIN E KONFORMITETIT, KLASIFIKIMIN DHE MARKIMIN CE TË PAJISJEVE MJEKËSORE”,pika 8.4,.

7. Ofertuesi duhet te paraqese vetëdeklaratë:

- Që merr përsipër trajnimin e dy personave (mjekë dhe teknikë) për cdo pajisje.
- Per furnizimin sipas kerkeses se AK, me pajisje te reja, sipas prodhuesit te deklaruar ne oferte.
- Për përmbushjen e afatit të garancisë sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të DST, saktesoje se periudha e garancise te jete jo me pak se 2 dy vjet perfshirë blerjen , dhe zevendesimin e pjeseve te difektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale.
- që merr persiper të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në vendin e dorëzimit.

8.Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen

shqipe dhe te noterizohen). **Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes.** Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

9.Operatori ekonomik duhet te paraqese **oferten teknike**, per pajisjet objekt, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

10.Operatori Ekonomik duhet te paraqese Autorizim per tregtim te pajisjeve mjekesore te leshuar nga Ministria e Shendetesis sipas ligjit 89/2014 per ‘Pajisjet mjekësore ***KREU V SHPËRNDARJA E PAJISJEVE MJEKËSORE, Neni 21 Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore.***

11. Dokument qe verteton qe pajisjet janë te regjistruara pranë Agjensisë Kombetare të Barnave dhe pajisjeve mjekesore (AKBPM) sipas ***ligjit 89/2014 per “Pajisjet mjekësore, KREU III REGJISTRIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE Neni 13 Procesi i regjistrimit.***

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I:

Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p>

	Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	_____
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
